

FJALA E DEPUTETES ANDIA ULLIRI

E HËNË 31 TETOR 2022

Shpresoj që koha që u mor nga parlamenti, të rikthejë fokusin tek ai që është i rëndësishëm sot: diskutimi për raportet e punës së Komisionit të Reformës Administrative-Territoriale!

Së pari, reforma e vitit 2014 në mbarë Shqipërinë ka rezultuar problematike, që është pasuar nga një sërë problematikash, duke cilësuar se është pasojë e metodës së përdorur, e cila niste nga lart poshtë dhe jo anasjelltas. Që një proces të jetë demokratik, ai duhet të marrë parasysh mendimin e çdo qytetari. Si anëtarë të këtij komisioni ne zhvilluam mbledhje dhe takime me qytetarë në qarqe të ndryshme, duke diskutuar dhe duke evidentuar problematikat e reformës së vitit 2014, si dhe ato të pushtetit vendor në situatën ekzistuese. Në këto takime pamë që kishte mungesë përfaqësimi, mungesë shërbimesh në zonat rurale, qeverisje larg qytetarit, paqartësi administrative, zyra të njësive vendore pa asnjë funksion etj. Këto problematika, ndër të tjera, e kanë origjinën nga çështja e kufijve territorialë, çështja administrative dhe decentralizimi.

Shqipëria sot, më shumë se kurrë, ka nevojë për një reformë, e cila në themel të saj ka interesin qytetar, autonominë vendore e financiare, decentralizimin, gjithëpërfshirjen, sidomos përfaqësimin. Ecuria e pushtetit vendor duhet të vlerësohet nga dy këndvështrime: së pari, nga efikasiteti i funksionimit, së dyti, nga kapaciteti i decentralizimit real, që bart jo vetëm korniza ligjore, por të gjithë veprimtarinë shtetërore në këtë drejtim. Si deputete e qarkut të Durrësit kam insistuar në rishikimin e kësaj reforme dhe në çdo seancë kam pasqyruar shqetësimet e qytetarëve të këtij qarku. Banorët e Fushë-Krujës, të Niklës dhe të Bubqit shprehen se problemet në zonën e tyre po thellohen dita-ditës. Përtej tërmetit dhe rindërtimit, kjo zonë prej kohësh ishte harruar nga pushteti vendor.

Po u drejtohem këtyre banorëve me pyetjet: sa afër i kanë shërbimet sot? A po i marrin shërbimet bazë? Sa transparencë tregon pushteti vendor me qytetarët? Sa të përfaqësuar ndihen sot në këshillat bashkiakë? A i është përgjigjur çdo banori pushteti vendor, qoftë atij në Malësinë e Krujës, qoftë atij në qytetin e Fushë Krujës? A i është përgjigjur çdo banori pushteti vendor i Bashkisë së Durrësit, qoftë ai në Ishëm, qoftë ai në qytetin e Durrësit? Nëse taksat i paguajmë njësoj, pse s'i marrim shërbimet njësoj? Këtu, të nderuar kolegë, çalon demokracia e pushtetit vendor. Sot ne duhet t'u drejtohem me përgjigjet

e duhura qytetarëve që përfaqësojmë. Të ofrojmë një alternativë funksionale, gjithëpërfshirëse, ku çdo qytetar të vlerësohet njësoj, kudo që zgjedh të jetojë, sepse ky është themeli i demokracisë.

Të gjithë ne do të gënjenim nëse do të mohojmë se nuk i kemi ndierë problematikat e reformës së kaluar. Ne nuk mund të themi se reforma e 2014-ës ishte alternativa më e mirë që mund të ofrohej. Sot jemi veshur me përgjegjësinë e marrjes së një vendimi, i cili korrigjon gabimet e së shkuarës dhe po na kërkohet të reflektojmë edhe për disa vite të tjera për një reformë që nuk funksionon. Sot ne duhet të eksplorojmë çdo mundësi dhe propozim që na sjell autonomi, decentralizim dhe demokraci vendore. Nëse më lejoni, dua të fokusohem te qarku që përfaqësoj, ai i Durrësit, sepse dua t'i ofroj këtij parlamentit mundësinë të reflektojë mbi realitetin e hidhur. Qarku i Durrësit përbëhet sot nga 3 bashki: Bashkia e Durrësit, Bashkia e Shijakut dhe Bashkia e Krujës. Partia Demokratike dhe opozita propozojnë edhe 2 bashki të reja në qarkun e Durrësit, të cilat vijnë nga një analizë e thellë, bazuar në kriteret e rivlerësuara nga ekspertët. Bazuar në historikun e këtij qarku, ne duhet t'i adresojmë siç duhet kërkesat e vazhdueshme të qytetarëve.

Një qark me një potencial të madh, me zona industriale të shumta, zona turistike, qytete historike nuk mund të kufizohet në këtë mënyrë. Është e papranueshme të mendosh që Bashkisë së Durrësit mund t'i shkojë në mend të investojë në Ishëm, kur ai qytetari i Durrësit kalon çdo ditë para bashkisë, ndërsa qytetarit të Ishmit i duhet të përshkojë 40 kilometra. Bashkia e Sukthit është një nga bashkitë që propozohet nga bashkimi i tri njësive administrative të Durrësit (Sukth, Ishëm, Manëz). Në listën e bashkive të reja që krijohen nga ky riorganizim, Ishmi është bashkia më e madhe në popullsi. Baza e zhvillimit ekonomik të kësaj bashkie janë: bujqësia, shërbimet, tregtia, turizmi dhe perspektiva për urbanizim. Vija bregdetare e Ishmit është zemra e turizmit, por jo vetëm për këtë bashki. Ka urbanizim dhe qendër me perspektivë urbane të trashëguar, por edhe potenciale për të nesërmen. Janë 52 mijë e 621 banorë, të cilëve u deprimohen shërbimet. Këta banorë janë sot më larg se kurrë me qytetin, urbanizimin dhe çdolloj gjithëpërfshirjeje.

Bashkia e dytë që propozohet është Bashkia e Fushë-Krujës, që propozohet nga bashkimi i 3 njësive administrative: Fushë-Krujë, që deri në vitin 2015 ka qenë bashki, dhe dy njësive administrative, Nikël dhe Bubq. Sipërfaqja e territorit të kësaj bashkie është 176 km² dhe ka një popullsi afro 50 000 banorë, si dhe ka një dinamikë zhvillimi të konsiderueshme. Baza e zhvillimit ekonomik në këtë bashki është një kompleks shërbimesh, mallrash, nga bizneset e vogla tek ato të mëdha, nga bujqësia te sektorë të tjerë, ndërtimi, prodhimi dhe shërbimi etj. Propozohet që kjo bashki ta ketë qendrën administrative në Fushë-Krujë.

Me dy rastet që ju dhashë, ne mund të kuptojmë vërtet se reforma ka çaluar, sepse 50 mijë banorëve nuk mund t'u deprimohet mundësia që të kenë bashkinë e tyre, të kenë autonomi vendore, të kenë autonomi financiare, të jenë të decentralizuar, të kenë më shumë shërbime, të kenë mundësi zhvillimi. Ky është pasqyrimi i qarkut të Durrësit.

Të nderuar qytetarë,

Nga kjo foltore unë dua të them se vërtet besoj se këto ndryshime do të jenë një hap pozitiv për qarkun e Durrësit, sepse besoj në ekspertizën që është bërë, në analizën, sidomos në dëshirën e banorëve për të pasur një përfaqësim demokratik, shërbime dinjitoze dhe gjithëpërfshirëse. Kur flasim për një reformë dinjitoze, ne nuk flasim për numra, por për efektshmëri dhe eficiencë; flasim për një paketë totale ligjore, e cila synon t'i ndreqë hapësirat e problemet, që ne si qytetarë përjetojmë çdo ditë.

Ne, si parlamentarë, duhet t'i garantojmë çdo qytetari mundësinë të jetojë i lirë, me të gjitha kushtet e shërbimet kudo që ndodhet. Ky duhej të ishte fokusi i reformës administrative-territoriale; ky duhej të ishte fokusi ynë dhe jo të na hidhej sot hi syve. Është detyra jonë të sigurojmë demokraci vendore dhe jo ta rrezikojmë atë, siç po bëjmë në diskutimet e sotme. Shqiptarët i kanë thënë dhe i kanë shprehur të gjitha shqetësimet e tyre ndër vite, ndaj ata tani po ikin dita-ditës, sepse ky parlament nuk ka zgjedhur t'i dëgjojë. Faleminderit!